

L I G J
Nr.7809, datë 30.3.1994

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.7566, DATË 25.5.1992 “PËR ARMËT”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7566, datë 25.5.1992 “Për armët”, në nenin 7 shtohen shkronjat “ç”, “d” dhe “dh” me këto përmbajtje:

“ç) Punonjësit e Policisë së Shërbimit Pyjor.

d) Punonjësit e Policisë së Ndërtimit.

dh) Punonjës të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit. Punonjësit që do të pajisen me armë zjarri dhe lloji i armatimit përcaktohen nga Kryetari i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Rendit Publik”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.820, datë 12.4.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.